

HYRJA NË FUQI E AKTEVE PËRMES BOTIMIT NË FLETORË ZYRTARE


MONITORIM
i akteve kryesore të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave
2006, 2007, 2008

Botimi 1

COMING INTO EFFECT OF ACTS THROUGH PUBLICATION IN THE
OFFICIAL JOURNAL (GAZETTE)

MONITORING THE PUBLICATION OF
THE MOST IMPORTANT ACTS ISSUED BY THE PARLIAMENT AND
THE COUNCIL OF MINISTERS
2006, 2007, 2008

Financuar nga:



OMBRA GVG

SERIA E BOTIMEVE LIGJORE

Titulli i botimit:
Hyrja në fuqi e akteve përmes botimit në Fletore Zyrtare
Monitorim i akteve kryesore të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave
2006, 2007, 2008
Botim i Qendrës për Çështjet e Informimit Publik, ÇIP



Website: www.infocip.org
e mail: qendra@cip-al.org

Ky botim u përgatit nga:

GERTI SHELLA
Drejtor Ekzekutiv
Qendra për Çështjet e Informimit Publik


© copyright 2009 - Autori
Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara.

Në realizimin e këtij monitorimi ndihmuan:
Av. Ardita Alsulaj
Milena Sauku, Juriste
Av. Saimir Kola
Përpunimi kompjuterik dhe pasqyrimi në website
Sulejman Vezi (webmaster)

* * *

Monitorimi i pasqyruar në këtë botim
u realizua në kuadër të projektit
"Kontroll verifikimi për zbatimin e ligjit për publikimet zyrtare,
me theks të posaçëm transparencën e VKM-ve..."

financuar nga:



Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve
dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Soros

HYRJA NË FUQI E AKTEVE PËRMES BOTIMIT NË
FLETORE ZYRTARE
2006, 2007, 2008



COMING INTO EFFECT OF ACTS THROUGH PUBLICATION IN THE
OFFICIAL JOURNAL (GAZETTE)
2006, 2007, 2008



“THE LAW CONSTITUTES THE BASIS AND THE BOUNDARIES OF THE STATE ACTIVITY”.

Article 4, paragraph 1,
Constitution of the Republic of Albania

**“ E DREJTA PERBEN BAZEN DHE KUFIJTE
E VEPRIMTARISE SHTETERORE”.**

neni 4, paragrafi 1,
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

his study, presented on this book-publication, is the outcome of a careful monitoring, which began in June 2009. This monitoring may be considered the first to be undertaken in Albania in the official publications field. It represents an objective attempt to generate findings through methodological verification. The method itself is the final product of a several year practical experience and of the best theoretical expertise that carries the Center for Public Information Issues; "CII" method is indeed a valuable asset.

Thanks to the support given by the Soros Foundation in Albania the application of this methodology became possible. The findings presented in this publication consist mainly on Parliament (Assembly) laws, normative acts (with the force of law) and decisions of the Council of Ministers which, in our opinion, should have been published in the Official Journal.

Official acts in question are presented on this publication merely as a title and only some of them as content too (mainly normative acts of the Council of Ministers with the force of law). In order to know or learn about the content of all these acts which have been identified as unpublished in the Official Journal over the years 2006, 2007 and 2008, you may visit the website of Center for Public Information Issues, www.infocip.org from where you can click directly on the title (formatted as link) so to reveal their full content directly from the official source where they are archived.

We hope that the findings and recommendations coming though this publication could serve the high state institutions to undertake necessary steps towards improving the actual practice and the legal framework in force with regard to official publication system in Albania. We also hope that this publication could serve the law students to better identify hotspots in the publication system in Albania so to promote their sense of criticism today and pave the way for the tomorrow's improvement made hopefully by them.

The Center would like to take this opportunity to thank the experts who were contracted to advance project phases during implementation and also to staff involved in the monitoring process, especially during methodological Component (link) II, labeled in this study as the "Factual Verification".

GERTI SHELLA
Project director, author

y studim që vjen përmes këtij botimi është produkt i një monitorimi të kujdesshëm i cili filloi në Qershor, 2009. Ky monitorim është i pari që ndërmerret në Shqipëri në fushën e publikimeve zyrtare dhe përfaqëson një përpjekje thellësisht objektive për gjenerim të dhënash përmes aplikimit të një metode të mirfilltë verifikimi. Kjo metodë është produkt i një përvoje disa-vjeçare e gërshëtuar me ekspertizës më të mirë teorike që mbart Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP; është një aset i vyer i saj.

Falë mbështetjes së Fondacionit Soros në Shqipëri u bë i mundur aplikimi për herë të parë i kësaj metodologjie për të gjeneruar gjetjet që prezantohen në këtë botim dhe që konsistojnë kryesisht në ligje të Kuvendit, Akte Normative (me fuqinë e ligjit) dhe vendime që nxjerr Këshilli i Ministrave të cilat, në gjykimin tonë, duhet të ishin botuar në Fletore Zyrtare.

Aktet zyrtare të pabotuara në Fletore Zyrtare, janë prezantuar në kuadër të këtij botimi thjesht si titull dhe vetëm disa prej tyre edhe si përmbajtje (kryesisht aktet normative të KM me fuqinë e ligjit), kjo për arsye të volumit jashtëzakonisht të madh që ato do të zinin nëse botoheshin edhe si përmbajtje. Por, përmes websitit të Qendrës ÇIP: www.infocip.org ju mund të njiheni me përmbajtjen e VKM-ve të pabotuara duke klikuar mbi titullin e aktit e cili është formatuar si link për të aksesuar të plotë aktin, direkt nga burimi ku arkivohet.

Ne shpresojmë që gjetjet dhe rekomandimet që vijnë përmes këtij botimi, t'i shërbejnë institucioneve të larta të shtetit për të përmirësuar praktikën aktuale, por edhe legjislacionit në fuqi për botimin e akteve në Fletore Zyrtare. Po ashtu, ne do të dëshironim që ky botim të mund t'i shërbente edhe studentëve të ligjit në universitetet e vendit për të kultivuar që sot gjykimin kritik në funksion të përmirësimit të sistemeve të publikimit nesër, kur ata të jenë praktikantë të ligjit.

Qendra ÇIP gjen rastin të falenderojë ekspertët e pavarur të cilët u kontraktuan në kuadër të këtij projekti për të avancuar hallkat metodologjike në implementim si edhe për stafin i cili u përfshi në procesin monitorues, sidomos në hallkën e dytë metodologjike, pikërisht ajo që në këtë studim është emërtuar "Verifikimi Faktik".

GERTI SHELLA
Drejtor i Projektit, autor

CONTENT

Chapter I. INTRODUCTION	10
A brief historic overview	10
An overview of the constitutional framework for official publications in the R.A.	12
An overview of the State Publication Center and the existing legal frame	20
Chapter II. THE PURPOSE OF MONITORING	28
CHAPTER III. RESULTS (FINDINGS)	34
Verification results, acts issued during 2006	36
Verification results, acts issued during 2007	46
Verification results, acts issued during 2008	52
Chapter IV. SUMMARISED CONCLUSIONS	64
Laws	64
Normative acts (with the force of Law) of the Council of Ministers	66
Decisions of the Council of Ministers (DCMs)	66
Chapter V. EXTRA CONSIDERATIONS	80
Chapter VI. RECOMMENDATIONS	88
Chapter VII. BRIEFLY ON METHODOLOGY	104
Chapter VIII. METHODOLOGICAL RESTRICTIONS	118
Chapter IX. DECISIONS OF THE COUNCIL OF MINISTERS , UN-PUBLISHED IN THE OFFICIAL JOURNAL (GAZETTE) OVER THE YEARS 2006, 2007, 2008 (ONLY IN ALBANIAN)	127
Chapter X Table 4, 5, 6	179
Chapter XI Table 7, 8, 9	205
Chapter XII Table 10	225
Chapter XIII Table 12	227

PËRMBAJTJA

Kapitulli I. HYRJE	11
Një vështrim i shpejtë historik	11
Një vështrim mbi kuadrin kushtetues për publikimet zyrtare në RSH	13
Një vështrim mbi Qëndrën e Publikimeve Zyrtare dhe kuadri ligjor ekzistues	21
Kapitulli II. QËLLIMI I MONITORIMIT	29
Kapitulli III. REZULTATET (GJETJET)	35
Rezultatet e verifikimit për aktet e miratuara gjatë vitit 2006	37
Rezultatet e verifikimit për aktet e miratuara gjatë vitit 2007	47
Rezultatet e verifikimit për aktet e miratuara miratuar gjatë vitit 2008	53
Kapitulli IV. KONKLUZIONE TË VERIFIKIMIT	65
Ligje	65
Akte Normative (me fuqinë e ligjit) të KM	67
Vendime të Këshillit të Ministrave	67
Kapitulli V. KONSTATIME EXTRA	81
Kapitulli VI. REKOMANDIME	89
Kapitulli VII. SHKURT PËR METODOLOGJINË	105
Kapitulli VIII. KUFIZIMET E METODOLOGJISË	119
Kapitulli IX. VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, VKM, TË PABOTUARA NË FLETORË ZYRTARE 2006, 2007, 2008	127
Kapitulli X Tabela 4, 5, 6	179
Kapitulli XI Tabela 7, 8, 9	205
Kapitulli XII Tabela 10	225
Kapitulli XIII Tabela 12	227

1

Chapter I

INTRODUCTION

— A brief historic overview

Publication of Official Acts constitutes one of the fundamental principles of the state. This principle affirms the condition for citizens to have the possibility to be informed of the legal norms issued by (state) governing bodies, so that they can implement them.

Since the time of Moses (Old Testament) up to the present time, this remains a firm principle of governance. Laws have constantly been written down: originally on stone, then on papyrus, later on paper, coming to the present days with the new leading information technology. In addition, Laws have been constantly proclaimed.

Moses has been used as an example in this case due to his popularity in Western culture. But the oldest legislative document of mankind is the Hammurabi's Code. The latter has prevailed in Babylon around 2200 BC (hence, more than 4000 years before our time.) Moses himself would take his revelation for the tables of the holy Laws on the Mount Sinai, no less than 500 years later since the time when Hammurabi proclaimed the Laws of his kingdom.

His Laws were strict and absolute. Hammurabi's Code was carved into a large slab of stone of black basalt (known as a **stela**) and displayed publicly. Thus, no citizen or slave could claim he was not aware of a certain Law or infraction. This **stela**, which stood 8 feet high, was discovered in 1901 in **Elam**, and is now housed in the **Musee de Louvre**.¹⁾

It is obvious that, in addition to the Law-giver's writing of Laws, they must be proclaimed in order for those who should implement and/or obey these

1

Kapitulli I

HYRJE

Një vështrim i shpejtë historik

Publikimi i akteve zyrtare përbën një nga parimet themelore të shtetit. Ky parim afirmon kushtin që shtetasit të mund të njohin normat ligjore që nxjerrin organet qeverisëse (shtetërore) në mënyrë që të kenë mundësi më pas t'i zbatojnë ato.

Që nga koha e Moisiut (Testamenti i Vjetër) e deri më sot ky mbetet një parim i pandryshuar i qeverisjes. Ligjet gjithmonë janë shkruajtur - fillimisht në gur, pastaj në papiruse, në letër e për të ardhur deri në ditët tona ku teknologjitë e reja të informacionit kanë marrë stafetën - dhe më pas, gjithmonë janë shpallur publikisht.

Moisiu është marrë në këtë rast si shembull për shkak të popullaritet që ai përfaqëson në kulturën perëndimore. Por dokumenti më i vjetër legjislativ i njerëzimit është Kodi i Hamurabit. Ky i fundit ka mbretëruar në Babiloni aty rreth viteve 2200 p.e.s. (pra janë më tepër se 4000 vjet që na ndajnë prej tij). Vetë Moisiu do të merrte revelacionin e tij për tabelat e ligjeve hyjnore mbi Malin e Sinait rreth 500 vjet me vonë nga koha kur Hamurabi shpalli ligjet e mbretërisë së tij.

Ligjet e Hamurabit ishin të rrepta dhe absolute. Kodi i Hamurabit u gdhend në një bllok të madhe guri prej basalti të zi (i njohur si stela) dhe shfaqej publikisht. Kështu, asnjë qytetar apo skllav mund të pretendonte se ai nuk ishte në dijeni të një ligji të caktuar. Stela, e cila ishte 8 metra e lartë, u zbulua në 1901 në Elami, dhe është vendosur sot në Muzeun e Luvrit.¹⁾

Është e qartë se, përveçse të shkruhen nga ligjvënësi, ligjet duhen njoftuar,

Laws are notified and/or presumably made aware of its existence. Moses, in addition of being a God's prophet, has also been the first who loudly asked from the people of Israel to implement the 10 Commandments (the Mosaic Law). He incorporates in one single unity the prophet, the leader, the legislator and the reveller (claimer).

Under the modern state, these attributions are separate functions and carried out institutionally. The publication of legal norms is one of the fundamental components of "Good Governance" and "Rule of Law". Publishing Laws and other official acts in the Official Journal (Gazette) presumes that all people have been notified of these acts. The state accomplishes its constitutional and legal obligation by publishing the official acts it issues if it expects from its citizens and its component institutions to execute and/or obey these acts. For this reason, the publication of Official Acts is a public service state must deliver at least on cost expenses.

In Albania, after the Proclamation of the Independence, governing authorities (especially during the time of ZOG 1st monarchy) have been careful so that (though quite formally in few cases) a town crier (in Albanian: tellall) could loudly tell the people (in most of cases illiterates) of the Laws and rules which set norms of conduct for them.

In the present Albanian modern state, the Official Journal is the historic and current document in which Official Acts are published. Its first issues, though in a rudimentary version, have supposedly been published upon the Proclamation of the Independence, thus when the Albanian state itself emerged.

An overview of the constitutional framework for official publications in the Republic of Albania

The Constitution of Albania, approved through people's referendum in 1998, gives special attention to the Law-making process, a key element of which is also the publication of Laws and other acts (decisions, orders) in the Official

pra t'i bëhen me dije atyre që duhet t'i zbatojnë. Moisiu, përveçse një profet i Zotit, ka qenë edhe i pari që me zë të lartë i kërkoi popullit të Izraelit të zbatonte 10 ligjet (porositë) e dhëna nga Zoti. Tek Moisiu mishërohet në një unitet të vetëm profeti, lideri, legjislatori dhe revelatori (shpallësi).

Në shtetin modern, këto funksione janë të ndara dhe ndërmerren institucionalisht. Publikimi i normave ligjore është një nga komponentët themelorë të "Qeverisjes së Mirë" dhe "Shtetit të së Drejtës". Botimi i ligjeve dhe akteve të tjera zyrtare në Fletoren Zyrtare prezumon faktin që të gjithë njerëzit vihen dhe janë në dijeni të këtyre akteve. Shteti përmbush një detyrim të tij kushtetues dhe ligjor, duke publikuar aktet juridike që nxjerr, në rast se pretendon që shtetasit e vet dhe institucionet që e përbejnë atë vetë duhet t'i zbatojnë këto akte. Për këtë arsye, publikimi i akteve zyrtare është një shërbim publik që shteti duhet të përmbushë të paktën me shpenzimet e kostos.

Në Shqipëri, pas shpalljes së Pavarësisë, autoritetet qeverisëse (sidomos në kohën e monarkisë së Zogut I) janë kujdesur fillimisht që, edhe pse formalisht në ndonjë rast, një tellall t'i komunikonte me zë të lartë masës së njerëzve (kryesisht analfabetë) ligjet dhe rregullat që vendosnin norma sjelljeje për ta.

Sot, në kohën e shtetit modern, dokumenti historik dhe aktual ku publikohen (botohen) aktet zyrtare në Shqipëri është Fletorja Zyrtare. Numrat e parë të saj, edhe pse në version rudimentar, mendohet gjithsesi të jenë botuar me Shpalljen e Pavarësisë, pra me fillesat e vetë shtetit shqiptar.

Një vështrim mbi kuadrin kushtetues për publikimet zyrtare në R.SH.

Kushtetuta e Shqipërisë, miratuar me referendum popullor në 1998, i ka kushtuar një vëmendje të posaçme procesit ligjvënës, ku një moment kyç është edhe botimi i ligjeve dhe akteve të tjera (vendime, urdhëresa) në Fletoren Zyrtare që i hap rrugë *de jure* dhe *de facto* hyrjes në fuqi të tyre.

Journal, paving the way *de jure* and *de facto* to their coming into force.

The third part of the Constitution, Chapter IV, Article 84, paragraph 3 says that “The Law enters into force within no less than 15 days after its publication in the Official Journal.” This is the ordinary procedure followed randomly after the legislative process is completed. But, the Constitution also provides for an extraordinary procedure when a Law enters into force, based on two cases: one linking with extraordinary measures and the other with necessity and emergency. In order for this extraordinary procedure to take place, the constitutional norm provides by appointing accurately that: 1) Parliament decides by the majority of all its members, 2) the President of the Republic gives his consent, 3) the Law is publicly proclaimed (three cumulative conditions). Besides, the Law shall be published in the first number of the Official Journal. In its seventh part, the Constitution has a provision on normative acts. Article 116 of the Constitution states that:

1. Normative acts that are effective in the entire territory of the R. A. are:
 - a. The Constitution;
 - b. International agreements;
 - c. The Laws;
 - d. The normative acts of the Council of Ministers.
2. Acts that are issued by the organs of local government are effective only within the territorial jurisdiction of these organs.
3. Normative acts of ministers and directors of other central institutions are effective within the sphere of their jurisdiction in the entire territory of the Republic of Albania.

Additionally, Article 117 of the Constitution of Albania provides that:

1. The Laws and the normative acts of the Council of Ministers, ministers and other central state institutions acquire legal effect only after they are published in the Official Journal.
2. The promulgation and publication of other normative acts is done in the manner provided by Law.
3. International agreements that are ratified by Law are promulgated

Në pjesën e tretë të Kushtetutës, kreu IV, nenin 84 , paragrafi 3 thuhet se “ Ligji hyn në fuqi jo më pak se 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare”. Kjo është edhe procedura e zakonshme e hyrjes në fuqi të ligjit. Norma kushtetuese parashikon edhe një procedurë të jashtëzakonshme të hyrjes në fuqi të ligjit dhe pikërisht në dy raste: atë të masave të jashtëzakonshme dhe atë të nevojave ekstreme. Këtë procedurë të jashtëzakonshme norma kushtetuese kujdeset ta rregullojë vetë duke përcaktuar se kërkohet që Kuvendi 1) të vendosë me shumicën e të gjithë anëtarëve, 2) Presidenti i Republikës të japë pëlqimin dhe 3) ligji të jetë njoftuar publikisht (tre kushte kumulative). Edhe në këtë rast ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Kushtetuta, pjesa e shtatë e saj, rregullon me normë kushtetuese aktet normative. Neni 116 i Kushtetutes përcakton se:

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSH janë :
 - a) Kushtetuta ,
 - b) Marrëveshjet Ndërkombëtare ,
 - c) Ligjet,
 - d) Aktet Normative të Këshillit të Ministrave.
2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit qëndror kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.
3. Akte normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qëndrore kanë fuqi në të gjithë territorin e RSH brenda sferës së juridiksionit të tyre.

Gjithashtu, neni 117 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton se:

1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, ministrave, të institucioneve të tjera qëndrore marrin fuqi juridike vetëm pasi të botohen në Fletoren Zyrtare.

and published according to the procedures contemplated for Laws. The promulgation and publication of other international agreements is done according to Law.

Also Article 122 of the Constitution states that: "Any ratified international agreement constitutes part of the internal legal system after it is published in the Official Journal of the Republic of Albania".

In relation to the mode of how Council of Ministers' acts enter into force, Article 29, Law No. 9000, dated 30.1.2003 "On the organization and functioning of the Council of Ministers" defines that:

1. Council of Ministers' normative acts, having the force of Law, are immediately published in the Official Journal.
2. Decisions of the Council of Ministers acquire legal force following publication in the Official Journal. With regard to normative character acts, a different date from that of publication in the Official Journal may be set as entering into force date, whereas decisions of individual character are effective immediately, but they are published in the Official Journal.
3. Council of Ministers' and ministerial instructions take legal force after their publication in the Official Journal.
4. Orders of the Prime Minister, minister or director of a central institution under the Prime Minister or the Minister, enter into force immediately; they are notified to the concerned persons and are displayed, for at least three days, in a conspicuous place of the relevant institution.

So, except for Prime Minister's Orders (Point 4, Article 29), in all other cases the publication of all Council of Ministers' acts in the Official Journal is obligatory.

As a conclusion, publication in the Official Journal of Laws, normative acts of the Council of Ministers, ministers and other institutions is a constitutional obligation and a juridical condition for these acts to enter into force. Failure

2. Shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj.
3. Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.

Edhe neni 122 i Kushtetutës përcakton se: “Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të RSH.”

Lidhur me mënyrën e hyrjes në fuqi të akteve të Këshillit të Ministrave, Neni 29, Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, përcakton:

1. Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare.
2. Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.
3. Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare.
4. Urdhrat e Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, hyjnë në fuqi menjëherë, u njoftohen të interesuarve dhe shpallen, për të paktën 3 ditë, në një vend të dukshëm të institucionit përkatës.

Kjo do të thotë se, me përjashtim të Urdhrave të Kryeministrit (pika 4, neni 29), botimi i çdo akti të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm me ligj në çdo rast.

Si konkluzion, botimi në Fletoren Zyrtare, i ligjeve, akteve normative të Këshillit të Ministrave, ministrave dhe institucioneve të tjera është një detyrim

to publish them in the Official Journal leads a-priori to the failure of their entering into force because one cannot benefit from or is not affected by a Law prohibition or permission unless he/she has real (formal) chances to know the Law. Publication of Laws and other official acts in the Official Journal presumes that everyone is informed of these acts. The state accomplishes its constitutional and legal obligation by publishing its own official acts if expecting from its citizens and its component institutions to respect and/or execute these acts. For this reason, publication of Official Acts is a public service the state shall deliver at least on cost expenses.

In order to accomplish this constitutional obligation and improve the practice of publication of Official Acts, the Center of Official Publications was established by *Law no. 8502, dated 29.6.1999*, changed by *Law no. 9091, dated 26.6.2003*. This was made possible thanks to support provided in the framework of a joint project between the E.U., Council of Europe and the World Bank. One of the key reasons for this important initiative was the identification of unpublished Official Acts, in particular of some Decisions of the Council of Ministers, DCMs.

Prior to the establishment of the Center of Official Publications, the Official Journal and its publication were under the institutional authority (dependence) of the Parliament. Probably this was the reason that Official Journal published mainly Laws and quite few Decisions of the Council of Ministers. With the insistency of the Council of Europe, a pressing duty of the Centre of Official Publications would be also to identify the unpublished acts (mostly DCMs) which should be processed in order to be published in the Official Journal as soon as possible.

Due to the affinity with the Law, but also in order to improve the publication practices, legal subordination of the Centre passed originally from the Parliament onto the Ministry of Justice, later on it was placed under the direct authority of the Minister of Justice, himself. (*Pursuant to Article 1 of the amended Law on the Centre of Official Publications, "the Centre of Official Publications is a central institution under the Minister of Justice". According to Law No. 8502, this Centre, based on Article 1, was "a state institution at directorate level under*

kushtetues dhe kusht juridik për hyrjen e tyre në fuqi. Mos-botimi i tyre në Fletoren Zyrtare shkakton apriori mos'hyrjen në fuqi për shkak të parimit, që nuk mund të përfitosh apo dëmtohesh nga një ndalim apo lejim i ligjit në rast se nuk ke mundesi reale (formale) të njohjes me të. Botimi i ligjeve dhe akteve të tjera zyrtare në Fletoren Zyrtare prezumon faktin që të gjithë njerëzit janë në dijeni të këtyre akteve. Shteti përmbush një detyrim të tij kushtetues dhe ligjor, duke publikuar aktet juridike që nxjerr, në rast se pretendon që shtetasit e vet dhe institucionet që e përbejnë atë vetë duhet t'i zbatojnë këto akte. Për këtë arsye, publikimi i akteve zyrtare është një shërbim publik që shteti duhet të përmbushë të paktën me shpenzimet e kostos.

Në plotësim të këtij detyrimi kushtetues, u krijua dhe Qendra e Publikimeve Zyrtare, me Ligjin nr. 8502, datë 29.6.1999, i ndryshuar me Ligjin nr. 9091, datë 26.6.2003, me qëllim përmirësimin e praktikës së botimit të akteve zyrtare. Krijimi i kësaj Qendre u bë falë mbështetjes në kuadër të një projekti të përbashkët të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës dhe Bankës Botërore. Një ndër shkaqet kryesore që motivoi këtë projekt të rëndësishëm ishte edhe konstatimi i mungesave në botimin e akteve zyrtare, sidomos të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, VKM.

Para krijimit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Fletorja Zyrtare dhe botimi i saj ishin varësi institucionale e Kuvendit. Për shkak ndoshta dhe të kësaj varësie, në Fletore botoheshin kryesisht ligje dhe shumë pak vendime të Këshillit të Ministrave. Me insistimin e Këshillit të Europës, një nga detyrat emergjente të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, shkurt QPZ, do të ishte edhe identifikimi i akteve të pabotuara (kryesisht VKM) për të cilat ishte e nevojshme të botoheshin sa më parë në Fletoren Zyrtare.

Për shkak dhe të afërsisë me ligjin por edhe me qëllim përmirësimin e praktikave të botimit, kjo Qendër kaloi nga varësi e Kuvendit nën varësi ligjore të Ministrisë së Drejtësisë fillimisht e më pas nën varësi direkte të vetë Ministrisë së Drejtësisë. *(Në bazë të nenit 1 të ligjit të ndryshuar për Qendrën e Publikimeve Zyrtare, "Qendra e Publikimeve Zyrtare është institucion qendror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë". Në ligjin nr.8502, kjo Qendër , në bazë të nenit 1,*

the Ministry of Justice”.

Various European countries have set different institutional subordinations for the institution (agency) which publishes Official Acts. For the majority of European states (mainly parliamentary republics), the publication of Official Journal is under Council of Ministers’ institutional subordination. This model was taken into consideration and accepted as the most relevant and most appropriate while drafting the legal framework for official publications in the Republic of Albania.

With the normal functioning of the Centre, hereafter as a central institution under the Executive branch of power, legal acts or norms, DCMs in particular, should have remained no longer unpublished. Likewise, accumulated stock of unpublished DCMs would reduce progressively through publication of “extra” Official Journals.

An overview of the State Publication Center and the existing legal frame

In the context of integration processes, the publication of Official Acts assumes special significance. Publication of Official Acts and guaranteed public access on them are two fundamental aspects of the Rule of Law and Good Governance. Article 1, third paragraph of the amended Law on State Publication Center, expressively states that:

“Through publications and other activities, the aim of the Centre is to make state bodies and other public administration institutions, physical and juridical persons aware of the Laws and international agreements, ratified or adhered to, of normative acts of the Council of Ministers, ministers and directors of other central institutions, other important acts issued by state bodies and institutions, and the text books of the literature of Law, to protect their rights and interests and consolidate legal and constitutional order”.

The Law on State Publication Center (SPC) clearly contemplates what is published in the Official Journal and determines the procedures and time

ishte “institucion shtetëror në rang drejtorie në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”.)

Vende të ndryshme europiane kanë përcaktuar varësi të ndryshme institucionale për agjensinë që boton aktet zyrtare. Në një pjesë të madhe të vendeve të Europës (kryesisht republika parlamentare) botimi i Fletores Zyrtare është varësi e Ekzekutivit. Ky model varësie u mbajt parasysh edhe në përpilimin e kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë për publikimet zyrtare.

Me funksionimin normal të QPZ, tashmë si një institucion qendror nën varësi të Ekzekutivit, nuk duhet të mbeteshin më akte apo norma juridike të pabotuara, sidomos VKM. Po ashtu, edhe stoku i akumuluar i VKM-ve të pabotuara do të duhej të pësonte zvogëlim progresiv si rezultat i botimit të tyre në Fletoret Zyrtare “extra”.

Një vështrim
mbi Qendrën e Publikimeve Zyrtare dhe kuadri ligjor ekzistues

Në kuadër të proceseve integruese, publikimi i akteve zyrtare merr një rëndësi të veçantë. Publikimi i akteve zyrtare dhe garantimi i aksesit të publikut tek to janë dy aspekte thelbësore të Shtetit Ligjor dhe Qeverisjes së Mirë. Neni 1, paragrafi i tretë, i ligjit të ndryshuar për Qendrën e Publikimeve Zyrtare, parashikon shprehimisht:

“Qendra, me anë të botimeve, publikimeve dhe veprimtarive të tjera **synon njohjen nga organet shtetërore dhe institucionet e tjera të administratës publike, nga personat fizikë dhe juridikë**, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, të akteve të tjera të rëndësi-shme të nxjerra nga organet dhe institucionet shtetërore, si dhe të teksteve e të literaturës juridike, në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, të forcimit të rendit juridik dhe kushtetues”.

limits for the publication of each official act. Concretely, *Article 2 of Law no. 8502, dated 29.6.1999, "On the establishment of the State Publication Center", and amended by Law no. 9091, dated 26.6.2003, expressively states:*

The SPC publishes:

- a) *International agreements, ratified or adhered to, Laws, decrees of the President of the Republic, normative acts of the Council of Ministers, ministers and leading bodies of other central institutions, decisions of the Constitutional Court along with the minority opinion, Supreme Court rulings for the unification and change of judicial practice, as well as any other act and document of state bodies, the publication of which is Law binding;*
- b) *Other subordinate-legal acts, which are not included in letter "a" of this Law;*
- c) *Official reports or other documents of state bodies and institutions, whose content is of state and public interest;*
 - ç) *The periodical magazine "Drejtësia";*
- d) *University Law text books, periodicals of central organs and institutions in the field of Law and Law literature;*
- dh) *general indexes and indexes for special areas assisting concerned subjects and the public."*

The Law makes clear provisions for the publication's mode of administrative acts carrying secret information. Article 5 of this Law says: *"The Centre does not publish normative sub-legal acts which are self-qualified as secret, according to Law. With the exception of acts which are legally binding for the public, the Centre is responsible for all publications regarding the observation of the state secret rules".*

Concerning the manner and procedure SPC follows to publish Official Acts, Article 6 of the referred Law contemplates that *"the organs which issue Official Acts shall submit these acts for publication within 3 days from the day of their approval, and in no case later than 15 days from the day of their approval."*

Ligji për Qendrën e Publikimeve Zyrtare bën parashikime të qarta se **çfarë** botohet në Fletoren Zyrtare si dhe përcakton qartë **procedurat** dhe **afatet** për botimin e çdo akti zyrtar. Konkretisht, në nenin 2 të Ligjit nr. 8502, datë 29.6.1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, të ndryshuar me Ligjin nr. 9091, datë 26.6.2003, parashikohet konkretisht:

Qendra boton:

- a) marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, ligje, dekrete të Presidentit të Republikës, akte normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, vendime të Gjykatës Kushtetuese së bashku me mendimin e pakicës, vendime të Gjykatës së Lartë për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe çdo akt e dokument tjetër të organeve shtetërore, botimi i të cilave është i detyruar me ligj;
- b) akte të tjera nënligjore, që nuk përfshihen në shkronjën “a” të këtij neni;
- c) raporte zyrtare ose dokumente të tjera të organeve dhe institucioneve shtetërore, përmbajtja e të cilave paraqet interes shtetëror dhe publik;
- ç) revistën periodike “Drejtësia”;
- d) tekste juridike universitare, periodike, të organeve dhe institucioneve qendrore në fushën e së drejtës dhe të literaturës juridike;
- dh) indekse të përgjithshme dhe indekse për fusha të veçanta në ndihmë të subjekteve të interesuara dhe të publikut.”.

Në ligj janë bërë parashikime edhe lidhur me mënyrën e publikimit të akteve që përmbajnë të dhëna me karakter sekret. Në nenin 5 të tij, ligji shprehet: “Qendra nuk publikon akte normative nënligjore, të cilat janë cilësuar nga vete akti, me karakter “sekret” sipas përcaktimeve të ligjit. Me përjashtim të akteve që ligjërisht janë të detyrueshme për publikim, Qendra mban përgjegjësi për të gjitha botimet lidhur me respektimin e rregullave për sekretin shtetëror”.

Lidhur me mënyrën dhe procedurën me të cilën QPZ publikon aktet

With regard to the deadline for SPC to publish these acts, *Law No. 8502 (amended by Law no. 9091)*, expressly sets deadlines based on the type of the act. According to Article 6, *“the Centre shall publish in the Official Journal the acts contemplated in letter “a” of Article 2 of this Law within 30 days from the date of their submission for publication by the responsible organ according to the Law.”*

The Official Journal is issued two times a month, every 15 days, on regular basis, but not later than 15 days from the submission for publication of the acts mentioned in letter “a” of Article 2 of this Law. The Official Journal may be published more frequently or before the programmed deadline after approval from the Minister of Justice or the SPC Council, based on a request from the responsible organ which has issued the act, or on the content of the provisions of the act submitted for publication (Article 7).

All acts submitted to SPC are recorded in the Center’s register, along with the notes on changes or repeals an act has had. This register is also available in electronic format. (*Article 12: the Centre creates the state master register of acts, with all mandatory acts for publication or acts to be published by the Centre in separate sections on repeals, amendments or additions after approval. The register can be also accessed electronically online..”*).

Thanks to World Bank support, SPC has now its internal data bases with where all acts published in the Official Journal are registered electronically. The World Bank project also improved online public access on legal norms. The Official Journals are currently uploaded on the official website of State Publication Center, www.qpz.gov.al and are accessible on the Internet.

The donors (in this case the World Bank) of the Centre always rejected its requests to increase capacity of printed publication of the Official Journal. The reason for refusal was the very high cost of this form of publication. In many advanced European countries, electronic publication has replaced hard copy publication and by applying Law amendments, online publication of Official Acts has acquired official (legal) value. So, in a considerable part

zyrtare, neni 6 i ligjit në fjalë parashikon që “organet të cilat nxjerrin akte zyrtare janë të detyruara të dërgojnë për botim këto akte brenda 3 ditëve nga dita e miratimit të tyre dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë nga dita e miratimit të tyre.”

Lidhur me afatin brenda të cilit QPZ është e detyruar që t’i botojë këto akte, Ligji nr. 8502 (*ndryshuar me Ligjin nr. 9091*), parashikon shprehimisht afate të caktuara në bazë të llojit të aktit. Sipas nenit 6, “Qendra duhet të realizojë botimin në Fletoren Zyrtare të akteve të parashikuara në shkronjën “a” të nenit 2 të këtij ligji brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre për botim nga organi përgjegjës sipas ligjit.”

Fletorja Zyrtare botohet rregullisht dy herë në muaj, në çdo 15 ditë, por jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja për botim e akteve të parashikuara në shkronjën “a” të nenit 2 të këtij ligji. Fletorja Zyrtare mund të botohet më shpesh ose përpara afatit të programuar, pasi të jetë marrë miratimi i Ministrit të Drejtësisë ose i Këshillit të Qendrës, mbështetur në kërkesën e organit përgjegjës, që ka nxjerrë aktin, ose në përmbajtjen e dispozitave të aktit të paraqitur për botim (neni 7).

Për çdo akt që vjen pranë QPZ, shënohen në regjistrin përkatës të gjitha të dhënat e tij si dhe shënimet lidhur me ndryshimet apo shfuqizimet që ka pësuar ky akt. Ky regjistër është edhe elektronik (Neni 12: Në Qendër krijohet regjistri shtetëror qëndror i akteve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e detyrueshme për botim ose që botohen nga Qendra me rubrika të veçanta për shfuqizimet, ndryshimet ose shtesat pas miratimit. Përmbajtja e regjistrit shfrytëzohet drejtpërdrejt dhe nëpërmjet sistemit informatik...”).

QPZ, falë mbështetjes së Bankës Botërore, ka krijuar database-in e vet të brendshëm, ku regjistrohen të gjitha aktet. Projekti i Bankës Botërore, konsistonte gjithashtu në rritjen e aksesit on-line të publikut të gjerë tek normat juridike. Aktualisht, fletoret zyrtare *upload*-ohen në faqen zyrtare të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, www.qpz.gov.al dhe janë të aksesueshme përmes internetit.

of EU countries, Laws and other official acts issued by the Executive branch become effective following online publication of the Official Journal (see: **Recommendations**).

Online publication has no legal value in Albania. Article 7, Law 8502 (amended by Law no. 9091) states: “SPC’s Council adopts the cases and modes of electronic publication of the Official Journal. The purpose for these publications is merely to inform the concerned persons of its content, without generating juridical consequences (effects).” Likewise, Article 7 states that “Full or partial replication of the Official Journal by third parties, through any type of means, is prohibited”.

Article 1, paragraph 2 of Law 8502 (amended by Law no. 9091) also states expressively that: “In addition to cases clearly contemplated in the Constitution, through Official Journal publication the Centre gives legal force to Laws, normative acts of the Council of Ministers, ministers and other central institutions.”

Article 7 of the same Law expressively states: “The Official Journal shall carry the date of its publication; otherwise it does not generate legal consequences.”

The council SPC adopts the cases and mode of electronic publication of the Official Journal. It should be highlighted ones more that online Official Journal publications aim to familiarise interested persons with its content **and they do not generate legal consequences (effects).**

Chapter II

THE PURPOSE OF MONITORING

Në asnjë rast donatorët e QPZ, nuk kanë pranuar kërkesat e vazhdueshme të Qendrës për rritjen e kapaciteteve të shtypjes së Fletores Zyrtare në letër. Arsyeja e këtij refuzimi lidhet me koston shumë të lartë të këtij lloj botimi. Në praktikat e përparuara të shumë vendeve europiane, botimi elektronik ka zëvendësuar plotësisht botimin në letër dhe me ligj të posaçëm i është dhënë vlerë zyrtare publikimit on-line të akteve zyrtare. Koncretisht, në një pjesë të mirë të vendeve të BE, ligjet dhe aktet e tjera zyrtare të nxjerra nga ekzekutivi hyjnë në fuqi pas botimit të fletores zyrtare on-line (shih: **Rekomandime**)

Kurse në Shqipëri, publikimi on-line nuk ka vlerë zyrtare. Në nenin 7, Ligji nr. 8502 (ndryshuar me Ligjin nr. 9091) thuhet: “ Këshilli i Qendrës miraton rastet dhe mënyrat e publikimit elektronik të përmbajtjes së Fletorës Zyrtare. Këto publikime synojnë njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e saj dhe nuk sjellin pasoja juridike”. Po ashtu, në nenin 7 thuhet se: “ Ribotimi dhe publikimi i plotë ose i pjesshëm i Fletores Zyrtare nga të tretë , me çfarëdo lloj mjeti, është i ndaluar”.

Në nenin 1, paragrafi 2 i Ligji 8502 (ndryshuar me Ligjin nr.9091) thuhet gjithashtu shprehimisht se: “Përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, Qendra, nëpërmjet botimit të Fletores Zyrtare, bën të mundur që të marrin fuqi juridike ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore.”

Po ashtu, në nenin 7 të të njëjtit ligj, thuhet shprehimisht: “Në Fletoren Zyrtare detyrimisht shënohet data e botimit të saj, në të kundërt publikimi nuk sjell pasojë juridike”.

Këshilli i QPZ miraton rastet dhe mënyrën e publikimit elektronik të përmbajtjes së Fletores Zyrtare. Vlen të theksohet edhe njëherë se këto publikime *on-line* të Fletores Zyrtare synojnë njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e saj **dhe nuk sjellin pasojë juridike**.

2 The purpose of this monitoring is to identify the cases of Official Acts not published in Official Journals of 2006, 2007 and 2008, differently from constitutional provision and the requirements stated in:

- Law No. 8502, dated 29.6.1999, “On the Establishment of the State Publication Center”, amended by Law no. 9091, dated 26.6.2003,
- Law No. 9000, dated 30.1.2003 “On the organisation and functioning of the Council of Ministers”.

In the focus of this monitoring is the practice of publication of acts issued by the two most important state institutions: the Parliament and the Council of Ministers.

The aim of this monitoring, first of its type ever done in Albania, is to bring to evidence in quantity and quality terms Laws and / or Decisions of the Council of Ministers which, pursuant to legislation in force, should have been published in the Official Journal, but which are not, in fact .

The **monitoring technique** (verification) applied in this project context is an inter-relation of two components:

1. Methodological verification (of schematic character) based on acts’ numeric index criterion
2. A case by case investigation of journalistic character, comparing data deriving from at least two sources.

This inter-relation represents an innovative practice in the approach that specialised operators of civil society, like Center for Publication Issues, have decided to implement in view of the truth, public opinion and legitimate state institutions in Albania.

But let us return to the non-publication of acts in the Official Journal, which may occur for two reasons:

- a) Institutions issuing these acts have not forwarded them for publication, thus violating the constitutional and legal provision according to which they shall submit these acts for publication “*within 3 days and*

2

Kapitulli II

QËLLIMI I MONITORIMIT

Qëllimi i këtij monitorimi është identifikimi i rasteve të mos-publikimit të Akteve Zyrtare në Fletoren Zyrtare, 2006, 2007, 2008, në kundërshtim me përcaktimin kushtetues dhe kërkesat që përcaktojnë:

- Ligji nr. 8502, datë 29.6.1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, të ndryshuar me Ligjin nr.9091, datë 26.6.2003.
- Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

Në fokus të këtij monitorimi është praktika e botimit të akteve që nxjerrin dy institucionet më të rëndësishme të shtetit: Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.

Ky monitorim, i pari në llojin e vet, synon të evidentojë në terma sasiorë dhe cilësorë ligje dhe/ apo Vendime të Këshillit të Ministrave (përfshirë aktet normative me fuqinë e ligjit) të cilat, në bazë të ligjislacionit në fuqi, duhet të ishin botuar në Fletoren Zyrtare, por që në fakt nuk janë botuar.

Teknika e monitorimit (verifikimit) e përdorur në kuadër të këtij projekti është një ndërthurje e dy komponentëve:

1. verifikimi metodologjik (me karakter formal) sipak kriterit të indeksimit të akteve zyrtare
2. investigim rast pas rasti (me karakter gazetaresk), për ballfaqimin e të dhënave tek të paktën dy burime ku janë të publikuara akte.

Kjo ndërthurje përfaqëson gjithashtu një risi në qasjen që operatorë të

in no case later than 15 days from the day of their approval.” (There is an exception made for the Council of Ministers’ draft (project) laws which are submitted to Parliament for approval and the decisions on “agreements’ approvals in principle..”.)

- b) State Publication Center itself has not accomplished its main mission, which is the publication of the Official Acts in the Official Journal within 30 days from their submission. (We underline again that a publication is considered to be official only when it is printed on paper, as the only mode (format) foreseen by the Law that may generate legal effects.)

This project does not intend to identify which of the two above-mentioned reasons is more frequently noticed in practice. In other words, the aim of this project is not **to identify and disclose the causes** leading to the non-publication of Official Acts in the Official Journal as required by the Law in force. This will be subject of another monitoring within the framework of this initiative. (The CII has developed an exclusively authentic methodology **to identify and disclose the causes** leading to non-publication of Official Acts in the Official Journal pursuant to the Law in force).

The afore-said project aims **to identify and show the consequences** generated from non-observation of the legal frame on Official publications in the Republic of Albania during (within) the monitored period 2006, 2007 and 2008. Presentation of the consequences in the context of this project will be restricted only to quantitative and qualitative identification (wherever possible) of Official Acts not published in the Official Journal. In other words, this project shows **“how many”** and possibly, where possible, **“what”** laws and / or decisions of the Council of Ministers have not been published in the Official Journal over 2006, 2007 and 2008.

Furthermore, this project does not make a qualitative analysis of the generated or missing effects of the Official Acts which are not published in Official Journal. Likewise, identification and presentation of the consequences here does not mean, let’s say, what is the damage caused to the state budget from a DCM with a certain financial connotation which has possibly generated certain effects prior entering first into force though

specializuar në monitorime të shoqërisë civile, sikurse është ÇIP, kanë vendosur të kenë në raport me të vërtetën, opinionit publik dhe institucionet legjitime të shtetit në Shqipëri.

Por, le të kthehemi tek mos-botimi i akteve në Fletoren Zyrtare. Kjo mund të ndodhë për dy arsye:

Konkretisht: **Ligji nr. 10125** dhe **Ligji 10126** (ratifikojnë marrveshje ndërkombëtare), që të dy datë 11.5.2009, botuar në Fletoret Zyrtare 66 dhe 67 të vitit 2009, (gjithmonë vetëm në internet, se botimi në letër gjatë kohës kur është realizuar ky monitorimi nuk kishte dalë nga botimi akoma), në dispozitë të tyre të fundit përcaktohen se “hyjnë në fuqi menjëherë”. Kushtetuta shprehet qartë lidhur me hyrjen në fuqi menjëherë të ligjeve. Në pjesën e tretë të Kushtetutës, kreu IV, nenin 84, paragrafi 3 thuhet se “ Ligji hyn në fuqi jo më pak se 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare”. Kjo është edhe procedura e zakonshme e hyrjes në fuqi të ligjit. Norma kushtetuese parashikon edhe një procedurë të jashtëzakonshme të hyrjes në fuqi të ligjit dhe pikërisht në dy raste: “*të masave të jashtëzakonshme dhe të nevojave ekstreme*”. Këtë procedurë të jashtëzakonshme norma kushtetuese kujdeset ta rregullojë vetë duke përcaktuar se kërkohet që: 1) Kuvendi të vendosë me shumicën e të gjithë anëtarëve, 2) Presidenti i Republikës të japë pëlqimin dhe 3) ligji të jetë njoftuar publikisht (tre kushte kumulative). Edhe në këtë rast, ligji duhet botuar në numrin më të parë të Fletores Zyrtare (shih: **Kapitulli I, Hyrje**). Në rastin në fjalë, me të njëjtin dekret njëkohësisht edhe është shpallur edhe është dhënë pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit, të paktën kështu rezulton nga verifikimi në kuadër të këtij monitorimi.

Një tjetër e dhënë interesante është konstatimi se Fletorja Zyrtare del në internet (format PDF) shumë kohë më përpara se të dalë nga shtypshkronja formati zyrtar (i printuar në letër). Në kapakun e Fletores Zyrtare që hidhet në internet në format PDF shënohet data e hyrjes dhe e daljes nga shtypi. Por, dalja realisht nga shtypi

format in hard copy). The cover of the Official Journal uploaded on the Internet in PDF format, carries the date of the Official Journal submission to and coming out of the press. But the real date of the print out does not correspond to the one announced on the Internet. It is a true fact that the content of the Official Journal (in *hard copy*) is identical with the one on the Internet (in PDF), but this does not solve the problem of the entering into force of Laws or other legal and subordinate legal acts. It is unacceptable that the Official Journal *soft copy* version is broadly accessed (in spite of the fact that it does not give the Law any legal power) before the official version (the one printed in paper) is put to circulation. In the best case, this significantly compromises the seriousness and reliability of the institution charged with the publication of the Official Journal (The State Publication Center). In the worst case, this generates sufficient reasons to throw real doubts on the true date of publication of the Official Journal considering the date marked on the hard copy cover. We remind here again that Article 7 of the Law no. 8502, expressively contemplates that:

“The Official Journal shall carry the date of its publication; otherwise it does not generate legal effects”.

Through it may be considered a superficial observation during this project’s process of implementation, it results that Official Journals of 2008 have come out of the press (print out) in first half of the year 2009. This can be easily verified by examining the entry and dispatch dates from the Albanian Post Office, which delivers the Official Journal to its subscribers. Referring to the law requirements on the State Publication Center functioning, this date (on which the Official Journal is delivered to institutions) cannot and shall not be later than 24 hours from the date when the Official Journal comes out of the press. Article 8, paragraph 3 of the Law no. 8502, dated 29.6.2003, contemplates that:

“Within 24 hours from the Official Journal publication, the Centre shall submit it to the central state organs and to the Post Office for the prefectures and other local government bodies; dissemination of its additional numbers is realised directly or on contract within 3 days, according to a special plan.”

nuk përkon me datën që reklamohet në internet. Është e vërtetë se përmbajtja e Fletores Zyrtare (*hard copy*) është identike me atë që hidhet në internet (PDF), por kjo e lë të pazgjidhur problemin e hyrjes në fuqi të ligjeve apo akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Është e papranueshme që versioni *soft copy* i Fletores Zyrtare të dalë në qarkullim të gjerë (pavarësisht faktit që nuk i jep ligjit fuqi juridike) përpara se të hidhet në qarkullim versioni zyrtar (ligjor). Në rastin më të mirë kjo kompromenton seriozitetin dhe besueshmërinë e institucionit që menaxhon botimin e Fletores Zyrtare (Qendra e Publikimeve Zyrtare). Në rastin më të keq, kjo prodhon mjaftueshmërisht arsye për të hedhur dyshime reale mbi vërtetësinë e daljes nga botimi të Fletore Zyrtare në datën që ajo mban të printuar në kapakun e saj. Kujtojmë edhe njëherë se, në nenin 7 të Ligjit nr. 8502, thuhet shprehimisht:

“Në Fletoren Zyrtare detyrimisht shënohet data e botimit të saj, në të kundërt publikimi nuk sjell pasojë juridike”.

Nga një vëzhgim jo i thelluar, në proces e sipër të implementimit të këtij projekti, rezulton se Fletore Zyrtare të vitit 2008 kanë dalë nga shtypi në gjysmën e parë të vitit 2009. Kjo mund të verifikohet lehtësisht nga datat e hyrjes dhe e daljes nga Posta Shqiptare, që shpërndan Fletoren Zyrtare në abonentet e saj. Po t’i referohemi kërkesave të ligjit mbi bazën e të cilit funksionon Qendra e Publikimeve Zyrtare, kjo datë (në të cilën duhet shpërndarë Fletorja Zyrtare nëpër institucione) nuk mund dhe nuk duhet të jetë më vonë se 24 orë nga data që reklamohet se ka dalë nga shtypi. Në nenin 8, paragrafi i tretë, i Ligjit nr. 8502, dt 29.6.1999, përcakton se:

“Qendra, brënda 24 orëve nga botimi, dorëzon Fletoren Zyrtare të detyrueshme në organet qendrore shtetërore dhe në postë për prefekturat dhe organet e tjera vendore, ndërsa për numrat shtesë siguron shpërndarjen me grafik të veçantë brenda 3 ditëve drejtpërdrejt ose me kontratime.”

Praktika e vonesës së daljes nga shtypi të Fletores Zyrtare *në letër* ka mbi një vit që është e zakonshme. Disa Fletore Zyrtare të vitit 2008 nuk ishin shtypur akoma në kohën kur përpilohej ky studim, në fund të 2009-ës. Kështu psh, vetëm Fletore Zyrtare nr. 129 i vitit 2008, kishte dalë realisht nga shtypi në mes të shtatorit 2009, kohë në të cilën filloi të përpilohej ky botim.

Delays in the Official Journal publication in *paper* are becoming a common practice for more than one and a half years now. In mid September 2009, when this report was underway, only the Official Journal number 129 of the year 2008 had, in fact, came out of the press. .

Based on a field investigation made in the context of this monitoring, in several cases citizens asking for copies of the Official Journal from the State Publication Center, do not have this service provided on demand, not to say about cases when they do not receive what they are expecting. In most of the cases, they are asked to return “later” or “the next day”. There is also another practice followed by the Center’s employee when the master copy is photocopied and delivered on payment which is several times higher than the price of the master copy itself.

Likewise, the SPC website manifests lack of performance, compromising the purpose why SPC as well as its electronic database was created for. To mention here is the almost difficult system for searching acts in the SPC electronic archives when a key-word search is applied, which is hard to be considered user friendly. Furthermore, in the course of this monitoring, it was noted that search engines are disorientated not to say failing or better blocked when the correct key-word is applied.

The “Extra” considerations presented above have not been subject to monitoring within the scope of this project. These came up when the process was underway and the authors considered these were of interest to be integrated in this report.

Chapter VI.

RECOMMENDATIONS

Nga hulumtimi në terren i kryer në kuadër të këtij monitorimi, qytetarët e interesuar që kërkojnë të marrin një kopje të Fletores Zyrtare pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në një pjesë të mirë të rasteve vonohen, për të mos thënë që nganjëherë nuk arrijnë të marrin atë që kërkojnë. Në shumicën e rasteve atyre iu kërkohet që të vijin “më vonë” ose “të nesërmen”, ndërkohë që ndiqet rëndom edhe praktika e fotokopjimit të origjinalit kundrejt një pagese disa herë më të lartë se sa çmimi i origjinalit.

Po ashtu edhe faqja *on line* e QPZ manifeston disa mangësi të cilat ulin performancën e saj, duke kompromentuar qëllimin përse ajo u krijua. Kështu, mjafton të përmendim se sistemi i kërkimit të akteve në arkivën elektronike funksionon në mënyrë pothuajse rudimentare teksa aplikohet kërkimi me fjalë-kyç. Po ashtu, gjatë implementimit të këtij monitorimi u konstatua se futja e më shumë se një fjale-kyç i çorienton motorrët e kërkimit duke bllokuar nxjerrjen e rezultatit të synuar.

Konstatimet “Extra” që janë renditur më sipër, nuk kanë qenë objekt monitorimi në kuadër të këtij projekti. Ato u hasën në proces e sipër dhe autorët gjyquan që ato janë me interes të përfshihen në këtë raport në mënyrë të përgjithësuar.

Kapitulli VI.

REKOMANDIME

Pas konsatimit të problemit përmes hulumtimit metodologjik, është e natyrshme që të vijohet me disa rekomandime të cilat besohet se mund t’i vlejnë përmirësimit të situatës.

Është ky rasti të theksohet edhe njëherë se ÇIP synon që, përmes ekspertizës që mbart dhe kapaciteteve të saj monitoruese të faktojë këtë nevojë për përmirësim.

6 Now that the problem is identified through methodological examination, it is logical to follow up with some recommendations which, we believe, will help improve the situation. We take this opportunity to underline again that through its expertise and monitoring capacities, the Centre for Public Information Issues, CII aims to prove the need for improvement.

It is quite obvious to initially suggest the Centre for Official Publications to publish in “extra” editions of Official Journals the acts which this monitoring has identified as unpublished. Center for Public Information Issues, CII strongly recommends that this “extra” edition publication start processing immediately.

By urging such step, we take into account or better say relay on the principle that by not publishing a normative act in the Official Journal, the act itself does not necessarily become non-valid, it is simply deprived of its legal force by not coming into effect; non-validity is judged separately and in complexity. The legal effects that an act might have generated prior to its publication in the Official Journal are considered in principal “null”, while the act itself is considered as non-existent¹⁰.

Another significant approach in the frame of these recommendations relates with the identification of causes that might have led to defects in the publications’ system functioning, resulting with the non publication of acts in the Official Journal, in our case, mostly acts issued by the Council of Ministers. In this respect, CII evaluates that the article 29 of Law no. 9000, dated 30.1.2003, “On the organisation and functioning of the Council of Ministers”, needs to be further improved, especially its paragraph no.2, where there is place for abuse with regard to the DCMs entering into force through publication in the Official Journal (Gazette).

Though this monitoring effort (intervention), introduced through this publication, represents the first of its kind ever done in Albania in the specific field, almost 10 years have passed now since the first approval of the **Law no. 8502, dated 29.6.1999, “On the establishment of the State Publication Center”**. This is quite a sufficient amount of time to come up with some considerations on the effects that this law was supposed to generate (produce).

Është një vijueshmëri e pastër llogjike që si fillim t'i rekomandohet Qendrës së Publikimeve Zyrtare botimi në Fletore Zyrtare “ekstra” i akteve të cilat janë evidentuar përmes këtij monitorimi si të pabotuara. ÇIP rekomandon trajtimin e menjëhershëm të këtyre akteve për botim.

ÇIP mban në këtë rast parasysh parimin se mosbotimi i një akti në Fletore Zyrtare nuk sjell detyrimisht pavlefshmërinë e tij, por pafuqinë e tij; vetë pavlershmëria gjykohet në kompleks. Efektet juridike që akti mund të këtë krijuar deri në momentin e botimit të tij, konsiderohen pa fuqi juridike, dhe akti vetë si i paqenë dhe që nuk ekziston¹⁰⁾.

Një tjetër qasje e domosdoshme në kuadër të këtyre rekomandimeve ka të bëjë me identifikimin e shkaqeve që mund të kenë prodhuar defekte në funksionimin e sistemit të botimit të akteve në Fletore Zyrtare, në rastin tonë, të akteve më të rëndësishme që nxjerr Këshilli i Ministrave. Lidhur me këto të fundit, ÇIP vlerëson se neni 29 i Ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” ka nevojë të përmirësohet, sidomos në pikën 2 të këtij neni, ku lihet hapësirë për abuzime sa i takon hyrjes në fuqi të VKM-ve përmes botimit në Fletore Zyrtare.

Edhe pse ky studim monitorues që prezantohet në këtë botim është i pari në llojin e vet në Shqipëri, kanë kaluar pothuajse 10 vjet nga miratimi për herë të parë i **Ligjit nr.8502, datë 29.6.1999**, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”. Kjo është një kohë e mjaftueshme për të gjykuar mbi efektet që ky ligj presupozohej të prodhonte.

Kujtojmë që, para miratimit të këtij ligji, botimi i Fletores Zyrtare ka qenë varësi institucionale e Kuvendit (pushtetit Legjislativ). Ligji për krijimin e QPZ e kaloi këtë të fundit në varësi institucionale të Ministrisë së Drejtësisë, e mandej në varësi direkte të vetë Ministrit të Drejtësisë. Arsyeja, sikurse është shpjeguar në kapitullin I, **Hyrje** të këtij studimi, lidhej ngushtësisht me thjeshtimin e burokracisë dhe zhdërvjelltësimin e praktikës së botimit për aktet e pushtetit Ekzekutiv, pra të

Just to remind: prior to the approval of this law, the publication of the Official Journal was institutional obligation of the Parliament (the Legislative branch of power). The **Law no. 8502, dated 29.6.1999**, put the SPC under the institutional authority of the Ministry of Justice, and later on under the direct authority of the Minister of Justice himself. The reason, as explained in *Chapter I, Introduction*, linked closely with the elimination of bureaucratic delays, for a more flexible publication practice on acts issued by the Executive branch of power, especially those of the Council of Ministers.

The data collected in the framework of this monitoring indicate that while the volume of acts issued by the Executive branch of power increases continuously (theoretically, it is a total of 1729 DCMs in 2008 only, compared to just 924 over 2007), proportionally increases also the number of the missing acts which result as not published in the Official Journal (**minimum 69 to maximum 295 DCMs** approved during 2007 and **minimum 218 to maximum 465 DCMs** approved during 2008).

This is a very meaningful indicator to see in a critical eye the potential of the current law to generate the effects that the law-maker intended at the moment of its approval.

The authors of this study hold the opinion that the present subordination of the State Publication Center under the Minister of Justice exposes the Centre itself towards vulnerable performance; the current subordination does not protect the Centre against hypothetical arbitrary demands that might come from heads of various ministries and/or other heads of high administrative institutions.

For this purpose, CII recommends to start examining alternative options for strengthening institutional subordination of the SPC and in the same time to ensure the adequate climate for the Center to fulfil its mission as required by law. *In the course of the conclusions and recommendations of this monitoring study, the CII aims to initiate a public and institutional debate for the improvement and modernization of the legal framework for official publications in the Republic of Albania.*

Real evidence in support of this recommendation is a case identified: when the

Këshillit të Ministrave, Ministrive, etj.

Nga të dhënat e mbledhura në kuadër të këtij verifikimi, konstatohet se tekса volumi i akteve që miraton pushteti Ekzekutiv vjen në rritje të vazhdueshme, (vetëm viti 2008 kap një total teorik prej 1729 VKM, krahasuar me vetëm 924 gjatë vitit 2007), po në rritje proporcionale reflektohen edhe mungesat në botimin e akteve (**më e pakta 69 dhe më e shumta 295 VKM** të miratuara gjatë vitit 2007 sikurse **më e pakta 218 dhe më e shumta 465 VKM** të miratuara gjatë vitit 2008,).

Ky është një tregues jashtëzakonisht domethënës që të shtyn për të parë me sy kritik potencialin e ligjit aktual për të gjeneruar efektet që ligjvënësi ka patur parasysh më momentin e miratimit të tij.

Në gjykimin e autorëve të këtij studimi, varësia aktuale e Qendrës së Publikimeve Zyrtare nga Ministri i Drejtësisë, e bën atë teorikisht vulnerabël; kjo varësi nuk e imunizon Qendrën ndaj kërkesave arbitrare, në kundërshtim me ligjin që mund të vijjë nga titullarë të digastereve të ndryshme.

Për këtë arsye, ÇIP rekomandon të shqyrtohen opsione alternative për varësinë institucionale të QPZ, me synim shtimin e kontrollit mbi të nga institucione të tjera kushtetuese dhe njëkohësisht për t'i garantuar asaj klimë të favorshme në përmbushje të misionit ligjor. *Qendra ÇIP synon të iniciojë një debat publik për përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor për publikimet zyrtare në Republikën e Shqipërisë.*

Një argument shumë ilustrues, në favor të këtij rekomandimi, është rasti i konstatuar i mos-botimit në Fletore Zyrtare të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 5543, datë 12.12.2007, “Per dekretimin e ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Japoni”. Si rezultat i një “vonesë” në botimin e dekretit, ai nuk mundi të paraqiste kredencialet e tij si ambasador në vendin pritës për rreth një vit, deri kur dekreti më në fund u botua.

Por, rekomandimi më prioritar që sugjerohet nga ky monitorim ka të bëjë me rishikimin tërësor dhe modernizimin e sistemit të indeksimit të akteve që nxjerr Këshilli i Ministrave. Sistemi aktual që përdoret mbart premisa për pasaktësi dhe mungesa në botimin e akteve të këtij institucioni shumë të rëndësishëm në Fletore

Decree of the President of the Republic, No. 5543, dated 12.12.2007 “*On the promulgation of the Ambassador of the Republic of Albania to Japan*” was not published in the Official Journal. As a result of this juridical-formal “delay”, he could not present his credentials as ambassador in the hosting country. The act mentioned above was published almost a year after the date when the relevant decree was promulgated by the President.

But, the most sensitive recommendation implied by this monitoring results relates to the thorough review and modernization of the indexing system used for acts issued by the Council of Ministers. The current system carries premises for inaccuracies and deficiencies in the publication of acts issued by this very important institution in the Official Journal. If the current system will continue to be at use, principles such as *Transparency in decision making process, Good Governance, Strengthening the Rule of Law* etc., will continue to remain compromised or just an illusion.

Another recommendation regarding such concerns relates to the publication of **project (draft) laws and agreements’ approval in principle** issues by the Government. As explained above, the two categories of Council of Ministers’ acts are not published in the Official Journal due to their non-definitive nature: the Parliament must further examine them before they are passed (ratified) as laws (or not).

The truth is that, within this monitoring, isolated cases when these type of acts are found published in the Official Journal, have been identified. **Law no. 8502, dated 29.6.1999**, “On the establishment of the State Publication Center”, amended by Law No. 9091, dated 26.6.2003, as well as **Law No. 9000, dated 30.1.2003**, “On the organisation and functioning of the Council of Ministers” do not make any provision that acts issued by the Council of Ministers in exercise of its authority to propose laws and sign agreements, shall not be published in the Official Journal. Both laws need further improvements and/or clarifications in this respect, in order to avoid miss-interpretation or arbitrary implementation.

The most typical case, recently emerged, that affirm and confirm this recommendation is the controversial agreement “*for the approval in principle of the agreement for delimitation of the continental shelf between Albania and Greece*”, which became a topic of intensive polemics in the media and in the public opinion. Lack of transparency in dealing with and addressing this agreement turned into a premise for political tensions between the main parties as well as a precedent which does

Zyrtare. Nëse sistemi aktual do të vijojë të përdoret akoma, parime të tilla si *Transparenca në Vendimarrje, Qeverisja e Mirë, Forcimi i Shtetit Ligjor* etj, do të vijojnë të mbeten të kompromentuara apo thjesht një iluzion.

Një rekomandim tjetër, që implikon natyrshëm këtë shqetësim, ka të bëjë me trajtimin për botim të **projektligjeve** të Qeverisë dhe **miratimit në parim të marrveshjeve** që ajo firmos. Sikurse kemi shpjeguar më sipër, këto dy kategori aktesh të Këshillit të Ministrave nuk botohen në Fletore Zyrtare pasi ato nuk janë me natyrë definitive: Kuvendi duhet t'i marrë ato për shqyrtim të mëtejshëm për t'i miratuar (ose jo) më pas.

E vërteta është se, në kuadër të këtij monitorimi, hasen disa raste të izoluara të botimit të disave prej këtyre lloj aktesh në Fletore Zyrtare. **Ligji nr nr.8502, datë 29.6.1999**, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, të ndryshuar me ligj nr.9091, datë 26.6.2003”, por edhe **Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003**, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nuk përcaktojnë në asnjë nen të tyre që këto akte që Këshilli i Ministrave nxjerr në ushtrim të kompetencës së vet për të propozuar ligje dhe lidhur marrveshje, nuk duhen botuar gjithashtu në Fletore Zyrtare. Për këtë arsye, të dyja këto ligje kanë nevojë t'i nënshtrohen përmirësimeve dhe/apo saktësimeve të mëtejshme në këtë aspekt.

Rasti më tipik i konstatuar së fundmi, që e përforcon këtë rekomandim ka të bëjë me “Miratimin në parim të marrveshjes për delimitimin e shelfit kontinental midis Shqipërisë dhe Greqisë”, e cila u kthye në objekt polemikash të shumta në media dhe në opinionin publik. Mungesa e transparencës në trajtimin e kësaj marrveshjeje u kthye madje në premisë për tensione politike mes partive kryesore por edhe në një precedent që nuk i shërben kultivimit të marrdhënieve të mira me fqinjët, në rastin konkret me Greqinë, një vend anëtar i Bashkimit Europian.

Qendra ÇIP rekomandon publikimin e këtyre lloj aktesh në edicione të posaçme botimesh, në funksion të transparencës qeveritare në vendimarrje, por edhe për t'i krijuar kujtdo mundësinë formale të njihet me këto akte para se ato të “ngurtësohen” në ligje apo ratifikime nga Kuvendi.

Pavarësisht se nuk është qëllim i këtij monitorimi, është shumë e rëndësishme të theksohet se nuk ka një mënyrë që të sigurohemi duke monitoruar nga jashtë

not encourage good relations with neighbouring states, in the concrete case with Greece, a European Union member country.

CII recommends the publication of such type of acts in special editions by the SPC, in order to serve transparency in government decision making, but also for anyone to become familiar, at list formally, with these acts before they “petrify” in laws or become ratified by the Parliament as a definitive agreement between states.

Though this is not the aim of this monitoring, it is very important to stress that there is no way, if monitoring from outside the institution, to ensure us that, **all** official acts that should and must be published in the Official Journal are realistically submitted to the State Publication Center within the time limit foreseen by the law.

Likewise, it is hard to verify whether all acts submitted to the State Publication Center, are in fact processed and published in the Official Journal. This can be achieved through a detailed case by case examination or periodical inspection of the register of acts, which is kept indispensably by State Publication Center, and through index examination of all acts published in the Official Journal.

The Ministry of Justice may carry out such an inspection, but it remains at the discretion of the Minister of Justice, who may not be always aware of the periodical regularity of Official Journal publication, even though he is the first person to receive a copy of the Official Journal within 24 hours after its print out (he is supposed to be the authority that carries the stamp (seal) of the state).

It is difficult to withhold (hide) from the Minister of Justice staff or the Minister himself the fact that the Official Journal is not issued (has a circulation of) as many copies as announced for the official record or that it is not distributed to subscribers within the time limit as contemplated by law. This creates real premises for abuse, i.e. the application of alternative methods to deliver on demand the Official Journal, through photocopies.

This premise for abuse may be easily avoided by changing the **Law no 8502, dated 26.9.1999**; the Albanian state recognises by law the legal effect of the Official Journal publication on the Internet (as a soft copy). In such case, only 3-10 copies

institucionit se, që të gjitha aktet zyrtare të detyrueshme për botim në Fletoren Zyrtare, dërgohen realisht pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj.

Po ashtu, nuk ka një mënyrë verifikimi që të gjitha aktet që kanë arritur në Qendrën e Publikimeve Zyrtare, janë botuar në Fletoren Zyrtare. Kjo mund të bëhet rast pas rasti apo periodikisht duke ushtruar kontroll të imtësishëm mbi regjistrin e akteve, që detyrimisht mbahet brenda Qendrës së Publikimeve Zyrtare, kombinuar me kqyerjen e indeksit të të gjitha akteve të botuara në Fletoren Zyrtare.

Ministria e Drejtësisë mund ta ushtrojë një kontroll të tillë, por kjo është në diskrecionin e Ministrit të Drejtësisë, i cili edhe mund të mos jetë gjithmonë i vetëdijshëm për rregullsinë e botimit të Fletores Zyrtare, edhe pse në fakt është personi i parë, si autoritetit që mban vulën e shtetit, që duhet të marrë një kopje të Fletores Zyrtare brenda 24 orëve të nxjerrjes së saj nga shtypi.

Stafit të Ministrit të Drejtësisë apo vetë atij, mund t'i fshihet lehtësisht fakti se Fletorja Zyrtare nuk është shtypur në të gjithë tirazhin e reklamuar si dhe që nuk i është shpërndarë abonentëve brenda afatit të kërkuar nga ligji. Kjo krijon premisa për abuzim, duke filluar që nga aplikimi i metodave alternative të shpërndarjes, sikurse janë ato me anë të fotokopjimit.

Kjo premisë abuzimi mund të eliminohet lehtësisht në rast se shteti shqiptar, me anë të ndryshimit të Ligjit nr. 8503, datë 29.6.1999, njeh efektin zyrtar të publikimit të Fletores Zyrtare në internet. Në një rast të tillë, mund të printohen vetëm 3 -10 kopje në letër, për efekt arkivor si dhe për t'i paraprirë çdo defekti apo manipulimi të mundshëm me sistemet online. Këto kopje autentike në letër mund t'i dorëzoheshin:

1. një Presidentit të Republikës,
2. një Kuvendit,
3. një Këshillit të Ministrave,
4. një Ministrit të Drejtësisë,
5. një Gjykatës Kushtetuese,

are enough to be printed out for archiving the archival purpose of publication and/or to precede any eventual problem such might be the manipulation of the *online* database. These authentic copies might be delivered:

1. one to the President of the Republic ,
2. one to the Parliament,
3. one to the Council of Ministers,
4. one to the Minister of Justice,
5. one to the Constitutional Court,
6. one to the Supreme Court,
7. one to the State Publication Center
8. one to the Ombudsman,
9. one to the State Archives,
10. one to the National Library.

A conference, called by the Forum of Centres of Official Publications in Europe, is held annually and its aim is to unify, improve and modernise procedures and systems of Official Acts publication. Among other things, this forum is a display of the latest contemporary practices from the most advanced countries whose example may be followed, along with the necessary amendments to be made to the legislation for official publications in Albania. The majority of European countries have abandoned (or are in the course of abandoning) the practice of publication of the Official Journal in a printed format. These countries have closed down gigantic printing establishments and by the time, with the development of technology, they have adopted a new legal approach which recognizes by law the electronic dissemination of legal norms. This has taken place for more than one reason:

- **Economical** – electronic dissemination of legal norms is much cheaper than those of the thousands printed copies of Official Journals, which cost a lot, need a big place for storage, and you can even forget to see those as the years pass.
- **Speed in dissemination** - electronic dissemination of legal norms is much faster, it is time-saving and effective above all (always based on the 100 % reliability on the system which shall be not erroneous and shall not allow

6. një Gjykatës së Lartë,
7. një ta mbante vetë Qendra e Publikimeve Zyrtare,
8. një Avokatit të Popullit,
9. një Arkivës së Shtetit
10. një Bibliotekës Kombëtare.

Çdo vit zhvillohet konferenca e Forumit të Qendrave të Publikimeve Zyrtare në Europë, që synon unifikimin dhe përmirësimin e procedurave të publikimit të akteve zyrtare. Ky forum është një ekspozë e përvojës më bashkëkohore nga ku mund të merret shembulli i vendeve më të përparuara dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në legjislacionin për publikimet zyrtare në Shqipëri. Shumica e vendeve evropiane kanë braktisur (ose janë duke braktisur) publikimin në letër të Fletores Zyrtare. Këto vende kanë mbyllur tashmë shtypshkronja gjigande dhe me zhvillimin e teknologjisë kanë adoptuar një qasje të re, duke njohur me ligj shpërndarjen elektronike të normave juridike. Kjo bëhet për shumë arsye:

- **Ekonomike** - shpërndarja elektronike e normave juridike është shumë më e lirë se shtypja në letër e mijëra kopjeve të Fletoreve Zyrtare, të cilat kushtojnë shumë, zenë shumë vend, dhe rallë i sheh njeri me sy me kalimin e viteve.
- **Shpejtësia në shpërndarje** - shpërndarja elektronike e normave juridike është shumë më e shpejtë, rrjedhimisht kursen kohë dhe mbi të gjitha është efektive (gjithmonë nëse mund të mbështetemi 100% në sigurinë e këtij sistemi: pa gabime dhe ndërhyrje nga jashtë).
- **Akresi i lartë nga publiku** - vendet evropiane kanë arritur një shpërndarje të gjerë të rrjetit të internetit në të gjithë vendin dhe akses të lartë të publikut në fondin (bankën) e normave juridike.

Arsyet e mësipërme janë në themel të nismave të marra këto vitet e fundit edhe në Shqipëri sa i përket shpërndarjes elektronike të normave juridike. Presupozohet që sot të jenë krijuar tërësisht kushtet edhe në Shqipëri që, në çdo komune apo bashki, të ekzistojë një post pune ku mund të aksesohet falas

for any outside interventions.)

- **Great public access** – European countries have a wide Internet extension throughout their territory and a great public access on the legal norms fund (bank).

The reasons mentioned above are the basis of initiatives undertaken in the recent years also in Albania regarding electronic dissemination of legal norms. We consider that Albania, too, has created already the basic conditions in order to provide in every commune or municipality a work station from which the State Publication Center website can be accessed online and any citizen can download from there all acts of interest for him/her, at any time.

But unless the necessary legal improvements are made, the Albanian state, on the one hand and the citizens, on the other, cannot enjoy the advantage of this technological progress.

For the moment, the current law remains to be entirely enforced and strictly observed. As long as this happens to be the case for Albania, any failure to have the Official Journal issued in a printed format is a violation of the Constitution and the law, causes the legal acts of the Albanian state non-coming into effect (non-enter into force), subsequently causing grave consequences to the state and its subjects.

When we say “grave consequences” we do not mean simply that the state has not accomplished its mission towards its subjects. This is only one aspect of the above assert. The grave consequences may fall on the state itself in the sense that the state, as a subject itself or better saying as party, does not realise, produce or benefit from the effects that the laws and subordinate legal acts it issues aim at. Let us **imagine a DCM on the application of a special tax increase to improve state budget incomes, which is not submitted for publication.** If the law enforcement bodies that execute this act might start to collect the supposed tax, regardless of the fact that the act is not published in the Official Journal. After some time, any subject affected by the application of this administrative measure has the right to claim the return of the tax money, and even compensation for the damage caused based on the legal argument that the tax has been collected arbitrarily on the basis of a normative

faqja e internetit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare nga çdo qytetar dhe nga ku mund të download-ohen aktet të cilat i interesojnë atij në çdo kohë.

Por, pa ndryshimet e nevojshme ligjore, shteti shqiptar nga njëra anë dhe qytetarët nga ana tjetër, nuk mund ta avantazhojnë veten nga këto përparësi teknologjike.

Për momentin, mbetet që ligji aktual në fuqi të zbatohet me rigorozitet. Për atë kohë sa ky të jetë rasti i Shqipërisë, çdo mos-botim i Fletores Zyrtare në letër është shkelje e Kushtetutës dhe e ligjit, me pasojë mos'hyrjen në fuqi të akteve juridike të shtetit shqiptar, rrjedhimisht me pasoja të rënda për qeverisjen.

Kur flasim për “pasoja të rënda”, nuk e kemi fjalën thjesht për mos-përmbushje të misionit të shtetit përballë shtetasve të vet. Kjo është vetëm njëra anë e pohimit të mësipërm. Pasojat e rënda mund të bien edhe mbi vetë shtetin në kuptimin kur ai është një palë që nuk realizon, prodhon apo përfiton efektet që synojnë ligjet dhe/apo aktet nënligjore që ai nxjerr. Imagjinoni një VKM që synon të aplikojë një tarifë të veçantë për të përmirësuar të ardhurat në buxhetin e shtetit, por kjo VKM të mos dërgohet për botim. Nëse, pavarësisht mos-botimit në Fletore Zyrtare, organet ligjzbatuese nisin efektivisht, pra de-facto, vjeljen e kësaj tarife të supozuar, në një kohë të dytë, çdo subjekti të prekur nga aplikimi i kësaj mase i lind e drejta të pretendojë dhe kërkojë kthimin e parave, madje dhe dëmshpërblim, pasi taksa është vjelë bazuar në një akt që nuk ka hyrë në fuqi, pra përmes një veprimi arbitrar. Për më tepër, në kuadër të përmirësimeve që ka pësuar dhe pëson kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë, në pritje edhe të miratimit së afërmi të ligjit për Gjykatën Administrative, shteti është “gjithmonë e më i barabartë” para ligjit me cilindo subjekt fizik apo juridik në Republikën e Shqipërisë.

Pra, e thënë në mënyrë përmbyllëse, botimi i akteve që nxjerrin institucionet e shtetit në Fletore Zyrtare, konform ligjeve në fuqi, është një detyrim imperativ, gjithmonë e më akut. Nga mosbotimi i tyre, shteti dëmtohet në të njëjtën masë që dëmtohet edhe vetë subjekti fizik ose juridik.

act which had not come into effect. Moreover, in the context of improvements that legal framework has marked and is marking in the Republic of Albania, and while the approval of the Law on the Administrative Court is expected soon, the state becomes “*more and more equal*” under the law as much as any other subject in the Republic of Albania.

In other words, publication in the Official Journal of the acts issued by state institutions, in compliance with the laws in force, is an imperative and a growing obligation. The non-publication of these acts causes equal harm to the state and to the subjects.

Another very important problem to be addressed within the context of this research-study is also the publication of the decisions of Municipal Councils, which have the force of law in the territory administered by each municipality. All these decisions should be published in a **local Official Journal (i.e. Local Bulletin)**, so that the people and business are informed and made aware of the decisions of their city representatives. As we speak, the situation in this respect is poor, not to say shocking. While, on the one hand, there is a dynamic process and an increasing institutional awareness on decentralization, with the local government accumulating more and more responsibilities which earlier “belonged” to the central government, on the other hand the attitude of the local government towards publication of the decisions it makes is almost obscurantist, having nothing to do with the spirit of the decentralization process itself, whose aim is to bring local level governance closer to the citizen.

Dozens of cases have been identified so far when citizens and/or juridical subjects are penalized for not paying the taxes in time simply because they have not been informed or aware of that the payment of certain taxes has a time limit and, the lowest penalty for the delay is 10 000 Lek, (at a time when the tax itself is no more than 1500 Lek.) This is the concrete case of “the tax on the sign-table” which by decision of the Municipal Council of Tirana shall be paid within 30 days from the registration date of the company. Here too, a sharp juridical problem arises too:

- a. When do acts of the municipal Council come into effect:

Një problem tjetër shumë i rëndësishëm për t'u trajtuar sado pak në kuadër të këtij studimi, edhe pse jo në fukusin e tij, është edhe botimi i vendimeve të Këshillave Bashkiakë, të cilat kanë fuqinë e ligjit brenda territorit që administrojnë çdo bashki. Është e domosdoshme që edhe këto vendime të botohen në **Fletore Zyrtare lokale** ose **Buletin Zyrtar**, që njerëzit dhe biznesi të njihet me vendimet e përfaqësuesve të tyre në nivel lokal. Aktualisht, në këtë drejtim situata është mjerane, për të mos thënë skandaloze. Teksa nga njëra anë ka një proces dinamik dhe një ndërgjegje institucionale në rritje për decentralizimin (e pretenduar me forcë së fundmi nga vetë përfaqësuesit lokalë), nga ana tjetër, sjellja e pushtetit lokal ndaj botimit të vendimeve që merr është pothuajse obskurantiste, pa asnjë lidhje me frymën që synon të përcjellë vetë procesi i decentralizimit, i cili synon që qeverisja në nivel vendor t'i afrohet gjithmonë e më shumë qytetarit.

Janë konstatuar dhjetëra raste kur, subjektet kthehen në objekt gjobitjeje për mospagim të taksave lokale në kohë, për shkak se nuk janë në dijeni që pagimi i taksave të caktuara ka afat dhe që, në rast vonese, gjoba më e vogël është 10 000 lek, (megjithëse vetë taksa nuk është më shumë se 1500 lek). Ky është rasti konkret i “taksës së tabelës” që me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës, duhet të paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të shoqërisë. Edhe këtu shtrohet po aq i mprehtë problemi juridik:

- a. Kur hyjnë në fuqi aktet e Këshillit Bashkiak:
 - ditën që miratohen?
 - 10 ditë pas miratimit?
 - apo 10 ditë pas shpalljes së tyre nga Kryetari apo sekretari i Këshillit Bashkiak?
- b. A ka një ligj që cakton se cili duhet të jetë dokumenti zyrtar ku botohen aktet e pushtetit lokal?
- c. A siguron bashkia akses në çmimin e kostos në internet për t'u njohur qytetarët me këto akte, apo të gjithë njerëzit që duan të njohin këto akte duhet të kalojnë domosdoshmërisht nga Bashkia dhe të lexojnë njoftimet e afishuara në tabela?

- the day when they are approved?
 - 10 days after approval?
 - Or 10 days after they are proclaimed by the Chairman or the Secretary of the Municipal Council?
- b. Is there any law defining which is the official document in which local government acts are published?
- c. Does the municipality provide any internet access, at the cost price, or the citizens who want to know these acts, must go to the Municipality premises to read the notifications publicly announced in charts?

As a conclusion, the Centre for Public Information Issues strongly suggests that the **publication of local government acts in a local Official Journal shall be Law-binding, allowing in this way to define also the day when these acts enter into force. Consequently**, the corresponding legal framework that regulates the functioning of the local government must be improved in order to pave the way for recovering the situation described above.

Chapter VII.

Si konkluzion, edhe pse jashtë objektit të këtij monitorimi, Qendra ÇIP sugjeron me forcë se **botimi i akteve të pushtetit lokal në një Fletore Zyrtare lokale duhet të jetë i detyrueshëm me ligj për të përcaktuar në këtë mënyrë edhe ditën e caktuar të hyrjes së tyre në fuqi**. Rrjedhimisht, kuadri ligjor korrespondues që rregullon mënyrën e funksionimit të pushteti lokal duhet përmirësuar për t'i hapur rrugë një praktike e cila do të mundësonte rikuperimin e situatës që iu referuam në paragrafin e mësipërm.

Kapitulli VII.

SHKURT PËR METODOLOGJINË

Problemi i mos-publikimit të akteve zyrtare nuk është i panjohur në sferën e debatit publik në Shqipëri. Në mëse një rast ka pasur madje deri edhe akuza prej forcave politike lidhur me mungesat që konstatohen në Fletore Zyrtare sa i përket VKM-ve.

Por deri më sot nuk është bërë asnjëherë ndonjë përpjekje metodike, rrjedhimisht objektive (jo në funksion të retorikës politike të ditës), për të identifikuar në terma

7

BRIEFLY ON METHODOLOGY

The problem of non-publication of Official Acts is not unknown in the public debate sphere in Albania. In some cases even accusations are made from political forces regarding missing publication of DCMs in the Official Journal.

But so far, no methodical attempt, subsequently no objective efforts (outside the daily political rhetoric) have been undertaken at all to identify in quantity and quality terms the Official Acts which have remained or left out of publication in the Official Journal.

Center for Publication Issues is the first specialised operator of the civil society who committed itself to develop a authentic methodology to be applied in the field of Official Publications monitoring. Thanks to Soros Foundation financial support, the organisation had a splendid opportunity to build monitoring capacities and make use of its own methodology in order to generate findings which guarantee impartiality, objectivity and reliability.

This methodology generates outputs not only for the 2006, 2007 and 2008 but for any time period selected and put under monitoring in regard to the publication of acts in the Official Journal. In this sense, this methodology is a “software” of expertise to be applied in the field of official publications monitoring and transparency. Regardless of the time period selected for monitoring and regardless of the person or entity applying it, the “CII” methodology generates objective, realistic and verifiable findings (outcome).

Considering the sensitive aspect of this monitoring in the context of integration processes the country is facing and the fact that this is the first of its type ever occurred in Albania, the CII has applied its own methodology at least three times over the same amount of acts that the Parliament and Council of Ministers have issued over the years 2006, 2007 and 2008. Each time, this methodology was applied by various groups of trained verifiers (operators) in order to guarantee impartiality, optimal testing of the methodology itself, along with its findings and conclusions.

sasiore dhe cilësore akte zyrtare të mbetura jashtë botimit në Fletoren Zyrtare.

ÇIP është i pari operator i specializuar i shoqërisë civile i cili mori përsipër të zhvillojë një metodologji të posaçme verifikimi në fushën e Publikimeve Zyrtare. Fale mbështetjes financiare të Fondacionit Soros, ÇIP pati mundësi të ngrejë kapacitete monitoruese dhe të aplikojë këtë metodologji për të gjeneruar të dhëna (gjatë) të cilat garantojnë paanshmëri, objektivitet dhe besueshmëri.

Kjo metodologji është e aftë të gjenerojë të dhëna jo vetëm për periudhën 2006, 2007, 2008, por për çdo periudhë kohore që përzgjidhet për t'u monitoruar sa i takon botimit të akteve në Fletore Zyrtare. Në këtë kuptim, kjo metodologji është një “software” monitorimi në fushën e publikimeve zyrtare. Pavarësisht periudhës kohore që përzgjidhet për t'u monitoruar, pavarësisht personit apo organizatës që e aplikon, Metodologjia “ÇIP” gjeneron të dhëna objektive dhe të verifikueshme.

Duke patur parasysh sensitivitetin e këtij monitorimi në kontekstin e proceseve integruese ku kalon vendi, por dhe faktin që ky është i pari në llojin e vet në Shqipëri, Qendra ÇIP ka aplikuar metodologjinë e zhvilluar prej saj të paktën tre herë mbi volumin e akteve që institucioni i Kuvendit dhe Këshilli i Ministrave ka nxjerrë gjatë viteve 2006, 2007 dhe 2008. Çdo herë, metodologjia është aplikuar nga grupe të ndryshme verifikuesish të trajnuar, për të garantuar paanshmëri në implementim dhe njëkohësisht kolaudim optimal si të vetë metodologjisë, ashtu edhe të gjetjeve dhe konkluzioneve.

Në terma të përgjithshme, Metodologjia “ÇIP” konsiston në dy hallka:

- I. **Skematike** - Identifikimi i akteve të pabotuara në Fletore Zyrtare, nëpërmjet shqyrtimit të rregullit kronologjik sipas llojit të akteve (ligje, vendime, etj). Kjo tenton t'i japë përgjigje pyetjes “sa” akte zyrtare (ligje, vendime, etj.) janë botuar dhe sa jo?
- II. **Faktike** - Kryqëzimi i gjetjeve nëpërmjet ballafaqimit të dy burimeve zyrtare ku arkivohen akte. Kjo tenton t'i japë përgjigje pyetjes “çfarë” akte zyrtare nuk janë botuar konkretisht (numër,

In general terms, the “CII” Methodology consists of two components or links:

- I. **Schematic** – Identification of unpublished acts in Official Journal, through chronological examination of the type of acts (Laws, Decisions, etc). This tend to give answer to the question “how many” Official Acts (Laws, decisions) have been published and how many of them have been not.
- II. **Factual** – Cross-examination of findings through comparison of two official sources in which acts are being stored. This tend to give answer to the question “what” concrete official acts have not been published (as number, title and content).

LAWS

When we start to *schematically* verify if all the laws passed by the Parliament during a given year are published in the Official Journal, all we need to know is the index number and date of the last law approved and published during the previous year or the number and date of the first law approved and published in the given year which is about to be monitored. It will be enough to start proving either the uninterrupted increasing numeric order that indexes the laws is undisturbed (has no gaps); if this will be the case, we may come to the conclusion that the laws approved by the Parliament during that given year are submitted and published in the Official Journal. But, in case when the numeric order that indexes the laws gets interrupted, this indicates that exactly the missing number which lacks the order may correspond to a law which has not been published. I.e. if the increased numeric order gets interrupted after Law No. 9466, to continue than at Law No. 9468, this obviously indicates that the Law No. 9467 is missing “the appeal”.

